



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3030/2 prot

Datë 07.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt: Blerje pajisje mobileri per shkollat e arsimit baze (Shkolla 9-vjecare "Adem Sheme dhe shkolla "9 Tetori", Sarande”, me fond limit 14,725,434.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarande
- Ankimues:** Operatori ekonomik “ERALD” SHPK, me NIPT J74517205P, me adresë: Rruga Nacionale Tiranë Fushë Krujë, km 132, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30, Durrës Nikël Qereke, Durrës
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Sarande, me adresë: Rruga “Abedin Dino”, Lagja Nr.1. Sarandë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK, me NIPT K21518003F, me adresë: Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I, Tiranë

Në datën 06.12.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. protokollin 3030/2023 datë 06.12.2023 e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK për procedurën e prokurimit “*“Procedurë e hapur”*”, me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt: Blerje pajisje mobileri për shkollat e arsimit baze (Shkolla 9-vjecare "Adem Sheme dhe shkolla "9 Tetori", Sarandë”, me fond limit 14,725,434.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ERALD” SHPK” lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për skualifikimin e operatorit ekonomik “Klame” SHPK, si më poshtë citojmë:

“ [...]

Së pari: Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” SHPK është anomalisht e ulët

Së dyti: Mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Klame” SHPK nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike sipas DST[...]”

2.3.10 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor. Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DST, të jenë:

Tavolinë nxënësi cikli i ulët:

Tavolinë nxënësi cikli i lartë:

Karrige nxënësi cikli i ulët:

Karrige nxënësi cikli i lartë:

Karrige mësuesi:

Tavolinë mësuesi:

Dollap për klasa:

Karrige rrotulluese:

Mosparaqitja e mostrave në ditën e hapjes së ofertave dhe ne rast se mostrat nuk janë ne përputhje me kerkesat dhe specifikimet teknike sipas DST, perben kusht skualifikues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.3.9 *Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë çertifikatat e produktit si më poshtë:*

• Tavolinë nxënësi cikli i ulët SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 e njëvlefshme ose e përditësuar.

• Tavolinë nxënësi cikli i lartë: SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 , e njëvlefshme ose e përditësuar.

• Karrige nxënësi cikli i ulët : SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e njëvlefshme ose e përditësuar.

• Karrige nxënësi cikli i lartë : SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016, SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e njëvlefshme ose e përditësuar.

• Karrige mësuesi: SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 e njëvlefshme ose e përditësuar

• Tavoline pune : EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, e njëvlefshme ose e përditësuar

• Dollap për klasa (Raft) : SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e njëvlefshme ose e përditësuar

• *Karrige rrotulluese (zyre): SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ,e njëvlefshme ose e përditësuar*

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet të jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet të disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 07.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova